



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 20 regjistër (JR)
Datë 21.04.2021

Nr. 24 i vendimit
Datë 22.05.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 22.05.2024, ditën e mërkurë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Bib Ndreca, gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në datën 19.01.2021, dhe në vijim gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 337, datë 18.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 dhe 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 62, 63, 65 e vijuese të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë; neni 442 e vijues i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në datën 19.03.2024, dhe në seanca gjyqësore publike në datat 23.04.2024, 14.05.2024 dhe 22.05.2024, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit dhe avokatja e tij, R. Z., në ankim, në parashtrime dhe në seancën gjyqësore publike, me anë të të cilave kërkoi shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave, duke administruar provat e reja, ndryshimin e vendimit nr. 337, datë 18.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes, Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Bib Ndreca (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për shkak të funksionit gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin Bib Ndreca, Komisioni ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLP”).
 - 3.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar për subjektin e rivlerësimit se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave¹.
 - 3.2. DSIK-ja kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, përmes verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo elemente që cenojnë figurën e tij, dhe ka konstatuar përshtatshmërinë në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit.²
 - 3.3. KLGJ-ja ka kryer analizën e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, si dhe të pesë dokumenteve

¹ Akti i kontrollit me nr. {***} prot., datë 8.01.2018.

² Raporti nr. {***} prot., datë 30.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së me nr. {***}, datë 07.07.2020.

të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar në Komision një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.³

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit. Në përfundim, me vendimin nr. 337, datë 18.01.2021, Komisioni vendosi shkarkimin e subjektit nga detyra. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, përfundimet e Komisionit janë si vijon:

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka *mungesë* të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, pas hetimit të pavarur dhe vlerësimit të shtatë denoncimeve të paraqitura, si dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese, subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

4.4. Përfundimisht, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vendosi shkarkimin e tij nga detyra.

III. Shkaqet e ankimit

5. Në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore, subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) kundër vendimit të përmbledhur më sipër, me fokus aspekte procedurale dhe ato që lidhen me themelin, të cilat parashtrohen të përmbledhura më poshtë. Më tej, subjekti i rivlerësimit, në datën 26.02.2024, paraqiti në Kolegji parashtrime me shkrim. Në vijim, në mënyrë të përmbledhur, pasqyrohen kërkimet e subjektit të rivlerësimit, parashtrimet dhe aktet e paraqitura prej tij.

A. Parashtrimet në ankim

6. Subjekti pretendon se ai vetë dhe procesi i tij i rivlerësimit në tërësi është paragjykuar, vendimi ka qenë i paracaktuar dhe është rezultat i cenimit dhe shkeljes së normave e rregullave procedurale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe rezultat i vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike të vërtetuara gjatë procesit të hetimit administrativ, për vlerësimin e kriterit të pasurisë. Sipas tij, aplikimi i nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si shkak për shkarkimin e tij nga detyra, për kriterin e pasurisë, është i pabazuar në prova dhe në zbatim të gabuar të ligjit. Bashkë me ankimin, subjekti ka sjellë disa akte shkresore në cilësinë e provave të reja⁴. Duke referuar shkaqet e parashtruara në ankim, bazuar në nenin 51 të ligjit nr.

³ Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. {***}, datë 12.02.2019.

⁴ Bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit paraqiti aktet shkresore të përmbledhura si vijon: (i) katër (4) kartela të klinikës dentare “{***}”, Tiranë, të datave 18, 20, 25 dhe 26 maj 2012, përkatësisht me numra {***}, {***}, {***}, {***}, në emër të katër individëve/pacientë; (ii) Akt-ekspertimi grafik (nr. {***}), datë 23.03.2021, i kryer nga një ekspert kriminalist, bashkëlidhur të cilat edhe disa dokumente, përfshirë tabelën pasqyruese të ekzaminimit grafik në fjalë, dëshmi për ekspert kriminalist dhe ekstraktin nga QKB-ja për këtë ekspert, një faturë e thjeshtë tatimore dhe transferta bankare

49/2012, në nenin F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 59, nenin 66, pika 1/b e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që Kolegji të vendosë:

- i. Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 337, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që mban datën 18.01.2021, dhe që lidhet më rivlerësimin kalimtar të tij;
- ii. Shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave, duke administruar provat e reja;
- iii. Ndryshimin e vendimit objekt ankimi të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.

6.1. Lidhur me aspektet procedurale të procesit të tij të rivlerësimit, duke pretenduar se vendimi ka qenë i paragjykuar dhe i paracaktuar, subjekti potencon: (i) faktin që hetimi administrativ fillimisht ka përfunduar vetëm për një kriter, pa marrë në konsideratë provat e paraqitura prej tij, dhe rrëzuar me një arsyetim sipërfaqësor kërkesën e tij të përsëritur për riçelje të hetimit administrativ, ndërkohë që kërkesa për riçelje të hetimit administrativ për të tria kriteret u pranua eventualisht, ndonëse nuk kishte ndryshuar asnjë shkak apo rrethanë, gjë që tregon paragjykim të çështjes. (ii) Edhe pse ishin depozituar raportet e DSIK-së dhe KLGJ-së, Komisioni u mjaftua me një hetim sipërfaqësor, paragjykues, vetëm me një kriter për të thirrur subjektin në seancë dhe për ta shkarkuar, duke cenuar të drejtat e tij për një proces të rregullt ligjor. (iii) Për shkak të elementeve të theksuara të paragjykimit dhe të vendimit të paracaktuar në të gjithë procedurën e ndjekur nga Komisioni, si mosmarrja në konsideratë e argumenteve dhe e provave të paraqitura prej tij në kuadër të barrës së provës, shqyrtimi i çështjes në seancë dëgjimore, pa dhënë asnjë shpjegim lidhur me vlerën provuese të provave të paraqitura prej tij, apo për arsyet e mospranimit të provave të kërkuara për t'u marrë, zhvillimi i seancës dëgjimore për një periudhë njëvjeçare, janë shkaqe për të cilat pretendohet shkelje e parimit të gjyqimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. (iii) Kalimi i barrës së provës, riçelja e hetimit administrativ dhe për dy kriteret e tjera, si dhe zhvillimi i seancave dëgjimore janë zhvilluar vetëm në dukje, me qëllim krijimin e bindjes se është respektuar procedura ligjore, për sa në seancë dëgjimore janë referuar gjetjet e raportit të hetimit administrativ kryesisht, pa reflektuar çfarë ndodhi pas riçeljes së hetimit administrativ. (iv) Është paragjykuar, pasi është shkarkuar edhe për informalitetin e një personi me të cilin vetëm ka hyrë në marrëdhënie kontraktore. (v) Vendimi i dhënë prej Komisionit ka arsyetimit të mangët dhe kontradiktor.

*për pagesën e saj; (iii) Deklaratë noteriale, datë 17.03.2021, e lëshuar nga një ish-notere e Dhomës së Noterisë Tiranë (znj. L. K.); (iv) Raport i një audituesi ligjor, mbi llogarinë në dollarë dhe euro të personit juridik, pronë e vëllezërve të subjektit (“***”), hartuar më datë 23.03.2021, dhe dokumentet bashkëlidhur, njësuar me nr. *** rep., datë 26.03.2021; (v) Kontratë huaje pa interes, e datës 20.01.2012, bashkëlidhur së cilës edhe një certifikatë regjistrimi e personit juridik, pronë e vëllezërve të subjektit, dokumentacion identifikimi i kumatës dhe i vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe kopje e njësuar e tyre, datë 26.03.2021; (vi) Vendim i asamblesë/ortakut të shoqërisë “***” ShPK, i datës 20.01.2012, kopje e njësuar me nr. *** rep., datë 26.03.2021; (vii) Certifikatë familjare dhe personale e A. N. dhe A. B., kopje të njësuara me nr. *** rep. dhe *** rep., datë 26.03.2021, dhe certifikatë familjare me vulë elektronike, kopje pasaporte për vëllain e subjektit (z. A. N.); (viii) Raport i audituesit të pavarur, për z. Sh. N., administrator i shoqërisë “***” ShPK, dhe znj. E. B., bashkëlidhur praktika përkatëse: kopje e letërnjoftimit të këtyre dy personave, e njësuar me nr. *** rep., datë 25.03.2021, vendim asambleje, kontratë huaje pa interes, certifikatë regjistrimi NIPT, kartelë klienti për prindërit e kumatës së subjektit, lëshuar nga Zyra e Bonove të Thesarit/Banka e Shqipërisë, nxjerrje llogarie për llogaritë në euro dhe dollarë, për shoqërinë “***” ShPK, kursi zyrtar i këmbimit, marrë nga faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë; (ix) Ekstrakt nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për të kumatën/të punësuarën, E. B. për periudhën dhjetor 2011 – gusht 2013.*

6.2. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë lidhen me pasurinë *apartament, me sipërfaqe 84.6 m², ndodhur në kompleksin “{***}”, rruga “{***}”, në Tiranë*. Në mënyrë të përmbledhur, ato përmbledhen si më poshtë:

6.2.1. Konkluzioni i Komisionit, se kontrata me të cilën subjekti ka blerë apartamentin (nr. {***} rep., nr. {***} kol.), datë 29.05.2012, është fiktive, është nënshkruar në mungesë të palës tjetër dhe shfaqjes së ligjshme të vullnetit të saj, *duke u shkelur rëndë etika*, është i gabuar dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe me parashikimet e neneve 30, 32, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

6.2.2. Konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën në shumën 40.000 euro, të kryer në datën 29.05.2012, për kalimin e të drejtave mbi pasurinë “apartament banimi”, është i gabuar.

6.2.3. Për burimin e të ardhurave të huadhënësit/personi tjetër i lidhur, vëllai (P. N.), në deklaratat periodike të pasurisë, në deklaratën *vetting*, dhe gjatë procesit të rivlerësimit, ka bërë të njëjtin deklaram, e konkretisht, se ka qenë kontratë kredie me kufi (nr. {***}/***, datë 04.03.2011, *overdraft*), që është përdorur në aktivitetin ekonomik nga huadhënësi/vëllai dhe të ardhurat e tij nga aktiviteti tregtar. Deklarimi i tij është keqinterpretuar nga Komisioni.

6.2.4. Aktet e administruara tregojnë mundësinë e huadhënësit me burime financiare të ligjshme, si individ dhe jo në cilësinë e personit juridik “{***}” ShPK, sikundër edhe është deklaruar prej tij në deklaratat periodike të pasurisë.

6.2.4.i. Konkluzioni se gjendja e arkës së shoqërisë në shumën 5.857.374 lekë, në datën 31.05.2012, sipas raportit të audituesit ligjor, nuk paraqet situatën reale, është i gabuar. Audituesi ka pasqyruar gjendjen e arkës në lekë, duke treguar burimin e saj, *overdraftin*, referuar shitjeve dhe blerjeve me arkë në lekë. Edhe pyetjet, edhe dokumentacioni i referohen veprimeve në lekë. Saktësia e rezultatit të audituesit ligjor për gjendjen e arkës nuk i është nënshtruar shqyrtimit dhe debatit në seancë dëgjimore. Për këtë arsye, atij i është mohuar mundësia për të provuar të kundërtën e çfarë ka konkluduar Komisioni në vendim.

6.2.4.ii. Për llogaritë bankare të shoqërisë në valutë (dollarë apo euro), të *papretenduara* asnjëherë si burimi i krijimit të shumës së huas, nuk kishte asnjë gjetje të Komisionit. Vetëm pasi ai (subjekti) u njoh me vendimin, ka ardhur në dijeni të arsytimit lidhur me këto llogari. Komisioni nuk ka kërkuar shpjegime për kreditime apo debitime të llogarive të shoqërisë në dollarë apo euro, duke i lënë gjetjet lidhur me to “surprizë” në vendim, dhe duke e vendosur atë në kushtet e pamundësisë për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova lidhur me veprimet e shoqërisë në këto llogari bankare të saj. Në qoftë se Komisioni do të kishte kërkuar shpjegime lidhur me transaksionet e shoqërisë në këto llogari, do të dorëzoheshin provat. Vëllezërit, P. dhe Sh. N., përkatësisht në cilësitë e ortakut të vetëm dhe administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, e kanë informuar që kreditimet në këto llogari kanë burim huan e marrë prej shoqërisë nga të tretët, shlyer brenda vitit. Për rrjedhojë, të gjitha provat lidhur me transaksionet e shoqërisë “{***}” ShPK në llogaritë e saj në valutë i paraqet përpara Kolegjit në cilësinë e provave të reja, duke kërkuar të administrohen dhe të vlerësohen prej tij.

6.2.5. Referuar parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe qëndrimit të Kolegjit⁵, subjekti i rivlerësimit duhet të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit *vetëm* për shumën e dhënë hua, dhe jo për pasuri, shuma apo transaksione të kryera nga huadhënësi në veprimtarinë e tij tregtare. Gjithashtu, mënyra si ortaku i *vetëm* krijon marrëdhënie me subjektin juridik apo si kjo marrëdhënie pasqyrohet në dokumentacionin financiar të shoqërisë, nuk janë përgjegjësi e subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, ai nuk mund të penalizohet për veprime të ortakut të *vetëm* apo të administratorit me subjektin juridik, shoqërinë “{***}” ShPK.

B. Parashtrimet përpara seancës së datës 19.03.2024⁶

7. Duke konfirmuar sa argumentuar dhe pretenduar në ankim, në këto parashtrime, bashkëlidhur të cilave paraqiti disa akte të reja shkresore,⁷ subjekti i rivlerësimit potencoi, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

7.1. Shkeljet e rënda procedurale të kryera nga Komisionit gjatë hetimit administrativ kanë dhënë një rezultat tepër arbitrar; çështja e tij meriton të konsiderohet “rast i drejtësisë së mohuar”, në mosrespektim të parimeve kushtetuese dhe garancive të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”). Përpos sa parashtruar në ankim, subjekti ngriti pretendime të reja, si vijon:

7.1.1. Mosrespektim të parimit të sigurisë juridike, pasi edhe pse shprehimisht nuk e thotë në vendim, me bazën ligjore të referuar në konkluzionin *se ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës*, nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 (dispozitë që referon në nenin 39 dhe 33 të po këtij ligji), Komisioni aludon se subjekti ka *cenuar besimin* e publikut te sistemi i drejtësisë.

7.1.2. Asnjë prej provave të paraqitura prej tij nuk ka gjetur pasqyrim në vendim. Sipas subjektit, provat dhe shpjegimet e kundërshtimit e tij “as nuk janë cituar” apo “sikur të mos ishin paraqitur fare”.

7.1.3. Konkluzioni i Komisionit, duke u bazuar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, është haptazi i pambështetur në ligj, për sa kjo dispozitë kërkon të plotësohet edhe kriteri i pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës. Për rrjedhojë, mosplotësimi i njërit kusht, për sa ato janë kumulative, bën që të rezultojë një mospërputhje totale e arsytimit të vendimit të Komisionit me referencën ligjore dhe disponimin e tij për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

7.2. Mbi themelin e ankimit, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, në këto parashtrime, subjekti i rivlerësimit ripërsëriti sa parashtruar në ankim lidhur me nënshkrimin e kontratës noteriale për kalim të drejtash nga z. Sh. A., duke potencuar se në procesin e rivlerësimit kalimtar, fuqia e provave shkresore përcaktohet drejtpërdrejt nga Kodi i Procedurës Civile; nuk është në diskrecionin e organeve të rivlerësimit të përcaktojnë vlerën e tyre. Komisioni ka tejkaluar dhe shkelur, në frymë dhe germë, Kushtetutën dhe ligjin.

⁵ Subjekti referon vendimet e Kolegjit nr. 8 (JR), datë 25.06.2020; nr. 28 (JR), datë 30.10.2019 dhe nr. 34 (JR), datë 02.12.2019.

⁶ Parashtrirat dhe aktet shkresore të përcjella nga subjekti i rivlerësimit janë depozituar në Kolegjin në rrugë postare dhe me postë elektronike, si dhe janë administruar më datë 26.02.2024.

⁷ Bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit paraqiti: (i) lëvizjet e llogarisë në emër të shtetasit Bib P. Ndreca, datë 26.01.2024; (ii) Vërtetim i lëshuar nga Banka ProCredit, datë 10.02.2022, me nr. prot. {***}; (iii) Kontratë shitje pasurie e paluajtshme (automjeti) nr. {***/{***}}, datë 18.12.2013, notere Sh. Gj., kopje e vërtetuar me nr. rep. {***}, datë 16.02.2024.

7.2.1. Lidhur me huan e marrë nga vëllai (z. P. N.), për blerjen e apartamentit, në parashtime, duke risjellë në pah argumentet e parashtuara në ankim, subjekti i rivlerësimit e pretendoi të gabuar dhe joobjektiv qëndrimin e Komisionit në paragrafin 64.7., që të mos përlogarisë në mesin e burimeve të ligjshme të vëllait (z. P. N.) kundrejt huadhënies, të ardhurat nga dividendi dhe paga, meqenëse subjekti ka shpjeguar se huaja ka për burim të ardhurat nga shitjet në periudhën janar – maj 2012, ndërsa i vëllai ka kryer edhe shpenzime të tjera. Subjekti argumentoi se Komisioni nuk duhej të kufizohej vetëm në deklaratimet dhe përgjigjet e tij, duke i dhënë atyre një qëndrim kategorik dhe joproporcional në raport me faktet, por duhej të kishte analizuar në drejtim të mundësive kumulative të huadhënësit për shumën e dhënë hua, të marrë pjesërisht nga aktiviteti ekonomik, kryesisht me bazë overdraftin, dhe të ardhurat e huadhënësit ndër vite nga ky aktivitet, për të verifikuar nëse ato justifikojnë shumën e huas.

7.2.2. Duke referuar lëvizjet e llogarisë së tij në ProCredit Bank, vënë në dispozicion me këto parashtime, subjekti potencoi se shlyerja e kredisë bankare marrë prej tij, nga e cila 37.000 euro kanë kaluar në llogarinë e vëllait/huadhënës për shlyerjen e huas, ka vijuar deri në datën 24.11.2021, kur ai dhe bashkëshortja kanë vendosur ta mbyllin kredinë në mënyrë të parakohshme, përmes dy paradhënieve bankare të marra pranë ProCredit Bank, për këtë qëllim. Këto veprime, të vërtetuara nga banka me shkresën e sjellë prej tij, datë 10.02.2022, tregojnë vërtetësinë e marrëdhënieve si me vëllain, ashtu dhe me bankën, për qëllimin e pasjes së një banese, për të cilën ka paguar kredi, principal dhe interesa të gjeneruara, për llogari të bankës, argumentoi subjekti.

7.2.3. Së fundmi, me parashtimet subjekti i rivlerësimit ngri pretendimin që, ndonëse Komisioni në vendim i referohet të ardhurave të pamjaftueshme të huadhënësit, nuk referon një vlerë të saj. Në shkelje të parimit e proporcionalitetit dhe të barazisë para ligjit, në çështje të tjera, Komisioni e ka konsoliduar qëndrimin, sipas të cilit, vlerat negative të vogla nuk janë vlerësuar si shkak që passjell zbatimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të parimit të proporcionalitetit, subjekti i rivlerësimit potencoi se pasuria *neto* e tij, e krijuar gjatë periudhës së rivlerësimit, është disa herë më e vogël në raport me të ardhurat. Ndërkohë, neni D i Aneksit të Kushtetutës parashikon si masë disiplinore shkarkimi, rastet kur subjekti ka një pasuri më tepër se dyfishi i të ardhurave të ligjshme.

C. Parashtimet në seancën gjyqësore publike të datës 14.05.2024

8. Siç shtjellohet në vijim, në seancën gjyqësore publike të caktuar nga trupi gjykues, në datën 14.05.2024, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij, duke u fokusuar në shkaqet e ankimit që lidhen me themelin e vlerësimit të pasurisë, në linjë me aspektet dhe argumentet në ankim dhe në parashtimet e paraqitura përpara seancës gjyqësore, në dhomë këshillimi. Duke konfirmuar përfundimisht kërkimin e tij në ankim, edhe në seancën publike, subjekti potencoi se:

8.1. Kontrata noteriale e datës 29.05.2012, për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve, lidhur mes tij dhe z. A., përmban të gjitha elementet e veprimit juridik të vlefshëm, ka sjellë pasoja konkrete, të dëshiruara dhe të ndërsjella për palët, sipas qëllimit të vetë kontratës. Si pasojë e saj, subjekti ka nëntë (9) vjet që e gëzon i qetë pasurinë e tij. Nuk ka asnjë veprim juridik fiktiv, e për rrjedhojë, as “shkelje etike”; nuk jemi në asnjë prej rasteve të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, për shkarkimin nga detyra të magjistratit.

8.2. Për huan nga i vëllai, për blerjen e apartamentit në Tiranë, konkluzionet e Komisionit janë tërësisht të pabazuara; ato janë rrjedhojë e një hetimi të mangët, interpretimi të gabuar të dispozitave ligjore të zbatueshme dhe e një analizë jo të drejtë të rrethanave dhe të fakteve të pasqyruara në akte dhe të deklaruara prej tij. Subjekti i rivlerësimit potencoi në mënyrë më të hollësishme argumentet e

parashtruara në ankim dhe në parashtrimet e datës 19.03.2024, në drejtim të konsistencës së deklarimeve të tij për burimin e krijimit të shumës së huas, si dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme të huadhënësit për dhënien e huas në vlerën 5.500.000 lekë. Parashtrimet e subjektit, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

(i) Në deklaratën e pasurisë të vitit 2012 dhe ato vijuese, në deklaratën *vetting*, në pyetësorë dhe në seancë dëgjimore, ka theksuar se burimi bazë për dhënien e huas ka qenë kontratë kredie me kufi (overdraft) nr. {***}/***, datë 4.03.2011, që është përdorur nga ana e të vëllait në aktivitetin ekonomik, dhe të ardhurat e tij nga biznesi. Ky aspekt nënkupton që të ardhurat e të vëllait buronin pikërisht nga aktiviteti i shoqërisë së tij, një aktivitet fitimprurës prej vitit 2002. Nuk ka deklaruar se shuma e huas ka kaluar në llogarinë e tij nga llogaria e overdraftit apo të jetë paraqitur me vëllain në bankë për të tërhequr shumën, ditën e dhënies së huas, fakt që provohet nga dokumentacioni i administruar, por edhe nga logjika ekonomike, si dhe mënyra si operon një aktivitet tregtar për marrjen dhe përdorimin e overdraftit, për nevoja të caktuara të veprimtarisë që ushtron apo qëllimit që ka në momentin e marrjes së kësaj kredie nga banka. Fakti që nuk ka detajuar shumën që u morën nga aktiviteti tregtar, që bazën e burimeve në atë kohë kishte overdraftin, dhe nga të ardhurat e të vëllait, nga paga dhe dividendi, apo që në seancë dëgjimore është fokusuar te detajimi i zërave të aktivitetit tregtar dhe të ardhurave në dispozicion të vëllait, për shkak të këtij aktiviteti, *nuk* ndryshon *burimin* e krijimit, mundësitë financiare dhe ligjshmërinë e të ardhurave të huadhënësit/vëllait, për dhënien e shumës së huas. Mungesa e detajimit nuk mund të interpretohet si ndryshim deklarimi për burimin e krijimit të shumës së huas.

(ii) Referuar në parashikimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çdo provë vlerësohet nga organi procedues në unitet me provat e tjera. Në rastin e tij, Komisioni ka bërë interpretim të gabuar dhe nuk ka marrë në konsideratë provat që vijnë nga burime të njohura e të besueshme, të paraqitura prej tij. Të dhënat nga aktet e administruara tregojnë qartë se huadhënësi/vëllai, P. N. kishte mundësi financiare për të dhënë huan me të ardhura të ligjshme. Me konkretisht, në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti fokusohet në aspekte si: tërheqja e shumës prej 5.000.000 lekësh, në datën 12.12.2011, nga shoqëria “{***}” ShPK, gjendja në arkën e shoqërisë për periudhën janar – maj 2012, që sipas raportit të hollësishëm të audituesit ligjor ishte në shumën 5.857.374 lekë, në datën 31.05.2012, të ardhura të ligjshme dhe të mundshme për t’i disponuar ortaku i vetëm, P. N. Së fundmi, dividendi i vitit 2010, shpërndarë në korrik 2011, prej 1.902.000 lekësh dhe shuma prej 130.000 lekësh, e përfutur nga P. N., nga pagat e periudhës 01.01.2012 – 30.05.2012.

(iii) Referuar analizës financiare të pasqyruar në përmbajtjen e vendimit, Komisioni i njeh se të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/vëllait, P. N., për dhënien e huas, ekzistojnë dhe ka konstatuar mundësi për krijimin e tyre, sidomos për shumën 1.800.000 lekë, pasi shuma prej 3.7 milionë lekë ka kaluar me bankë nga kredia bankare për rreth një muaj. Pavarësisht nga sa më sipër, Komisioni ka vendosur të mos i njohë të ardhurat nga dividendi dhe pagat, me argumentin “e padrejtë” që subjekti ato nuk i ka deklaruar si burim të krijimit të huas, pa marrë parasysh se në thelb i ka pretenduar ato, përderisa gjatë gjithë hetimit administrativ ka deklaruar se aktiviteti tregtar është i vetmi burim i rëndësishëm i të ardhurave të vëllait të tij.

(iv) Shkresat e ProCredit Bank, të paraqitura në Kolegj, lidhur me lëvizjet e tij të llogarisë, mbylljen e kredisë bankare të marrë për blerjen e apartamentit, koherenca e veprimeve të tij në periudha të ndryshme kohore, përpara dhe gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, tregojnë vërtetësinë e deklarimeve të tij, marrëdhënies korrekte me ligjin dhe me vëllazërit e tij. Veprimet e tij nga momenti i blerjes së apartamentit dhe deri në shlyerjen e plotë të kredisë bankare mbështeten vetëm në akte

shkresore, në lëvizje transaksionesh bankare, qartësisht të gjurmueshme dhe në respektim të plotë të kuadrit ligjor përkatës.

(v) Audituesi ligjor ka pasqyruar gjendjen e arkës në lekë, duke treguar edhe burimin e saj, që ishte overdrafti. Kreditimet në llogaritë bankare, në dollarë dhe euro, të shoqërisë “{****}” ShPK, kanë burim huan nga të tretët, sipas sqarimeve të vëllezërve dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion prej tyre. Për rrjedhojë, nuk qëndron konkluzioni i Komisionit, se rezultati i paraqitur nga audituesi ligjor për gjendjen e arkës, në datën 29.05.2012, nuk paraqet situatën reale, për sa në raportin e tij nuk janë pasqyruar kreditimet në *cash* në llogarinë në dollarë.

(vi) Ndonëse huaja që shoqëria “{****}” ShPK i ka marrë bashkëjetueses së vëllait të tij, Sh. N., nuk është pretenduar si burim për huan ndaj tij -- e për rrjedhojë, nuk ka lidhje me çka duhet të provojë ai si subjekt rivlerësimi -- ka paraqitur raportin e dytë të audituesit ligjor për veprimtarinë shoqërisë në euro dhe dollarë, për periudhën janar – maj 2012, dhe pyetjen e z. Sh. N., administrator i shoqërisë, i autorizuar për lidhjen e kontratës me znj. B. (huadhënësen për shoqërinë). Në raport pasqyrohen likuidimet me bankë nga shoqëria, për shlyerje faturash kundrejt të tretëve; po ashtu, audituesi thekson se nuk është shprehur për llogaritë e shoqërisë në valutë, në raportin e parë, pasi nuk i është kërkuar nga shoqëria, dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion ka qenë vetëm në lekë. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit, lidhur me kufijtë e shqyrtimit të pasurive të personave të tjerë të lidhur në cilësinë e huadhënësit⁸, subjekti ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e të ardhurave dhe burimet e krijimit të tyre vetëm për shumën e dhënë hua dhe jo për pasuri, shuma apo çdo transaksion tjetër të kryer nga huadhënësi.

(vii) Kontrata noteriale e huas, datë 22.06.2012, është lidhur mes tij dhe P. N., si individ. Shuma e dhënë hua u mor nga aktiviteti ekonomik -- kryesisht me bazë overdraftin -- dhe të ardhurat e fituara ndër vite nga aktiviteti tregtar i të vëllait. Dinamika e marrëdhënies së ortakut të vetëm me personin juridik dhe mënyra si kjo marrëdhënie pasqyrohet në dokumentacionin financiar, nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit dhe as të përbëjë shkak për largimin e tij nga detyra. Shuma e kredisë i është kthyer huadhënësit, konkretisht 3.7 milionë lekë, pas një muaji nga marrja e kredisë dhe 1.8 milionë në këste, të deklaruara hollësisht në deklaratat e pasurisë dhe deklaratën *vetting*.

(viii) Edhe pse ai ka provuar mundësitë financiare me të ardhura të ligjshme të huadhënësit për një shumë më të madhe se ajo e dhënë hua, Komisioni nuk tregoi sa ishte *pamjaftueshmëria* e huadhënësit, në cenim të parimit të barazisë para ligjit. Në jurisprudencën e tij, Komisioni ka qëndrim të konsoliduar për vlerat negative të konstatuara, në harmoni me provat e tjera, në zbatim të parimit të proporcionalitetit.

(ix) Konkluzioni për shkarkimin e tij nga detyra, mbështetur në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, është haptazi i pambështetur në ligj, pasi nuk është plotësuar kriteri kumulativ që kjo dispozitë kërkon, pamjaftueshmëria në kontrollin e figurës.

⁸ Subjekti referon vendimet e Kolegjit nr. 2/2023 (JR), paragrafi 17.13; nr. 15/2019 (JR); nr. 29/2022 (JR), paragrafët 52, 53 dhe 54; nr. 28/2022 (JR) dhe nr. 20/2019 (JR).

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit. Për rrjedhojë, çështja me objekt kundërshtimin e vendimit, nëpërmjet të cilit Komisioni ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Kolegji merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimitimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në Kolegji, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), çështja objekt gjykimi u mor fillimisht në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues”) në dhomë këshillimi, në datën 19.03.2024.

11.1. Në seancën e zhvilluar mbi bazë dokumentesh, më 19.03.2024, trupi gjykues i Kolegjit vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim konstatimin e plotë të situatës faktike lidhur me burimin e ligjshëm të huas së financuar nga personi tjetër i lidhur/vëllai i subjektit, z. P. N. në shumën 5.500.000 lekë, për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë. Trupi gjykues e mori këtë vendim bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës⁹, nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016¹⁰, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012¹¹.

11.2. Në seancën gjyqësore publike të datës 23.04.2024, për zhvillimin e së cilës, palët procedurale të këtij gjykimi ishin njoftuar me aktet përkatëse, vëzhguesi ndërkombëtar kërkoi shtyrjen dhe zhvillimin e seancës në një datë tjetër, pasi vëzhguesja ndërkombëtare që ka ndjekur këtë çështje, znj. Marie Tuma, për arsye objektive nuk mund të ishte prezente, ndërsa ai vetë nuk njihej me aktet. Subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesja e tij ligjore, avokatja R. Z., deklaruan se vendimmarrjen për

⁹ “[3.] Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. [...]”

¹⁰ “[6.] Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

¹¹ “[1.] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja, kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji. [...]”

kërkesën për shtyrje e lënë në vlerësim të trupit gjykues. Trupi gjykues vendosi të shtyjë seancën gjyqësore publike për në datën 14.05.2024, në orën 10:00.

11.3. Në seancën gjyqësore publike të datës 14.05.2024, subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesja e tij ligjore, znj. Z., parashtruan pretendimet sikurse në ankim dhe parashtrime, duke rikonfirmuar edhe kërkimin përfundimtar për: (i) shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave, duke administruar në cilësinë e provave të reja aktet shkresore të paraqitura me ankimin dhe ato të paraqitura në parashtrime; dhe (ii) ndryshimin e vendimit nr. 337, datë 18.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në atë moment me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat¹².

11.3.1. Trupi gjykues vendosi që t'i marrë, në cilësinë e provave të reja në gjykim, dymbëdhjetë (12) akte, sipas kërkesës së subjektit e përfaqësueses ligjore në seancën publike,¹³ por edhe në ankim e parashtrimet me shkrim, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016¹⁴. Këto akte u bënë pjesë e fashikullit të gjykimit. Trupi gjykues konstatoi se parashtrimi i këtyre provave me ankimin përmbush kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, për rrethanat në të cilat lejohen provat e reja me ankimin, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja "a" e të njëjtit ligj. Ky konkluzion mbajti në konsideratë si nevojën për konstatimin e drejtë të situatës faktike, përfshirë edhe nëpërmjet akteve të reja, shkak për të cilin seanca u zhvillua në prani të subjektit të rivlerësimit, por edhe pretendimin e subjektit që vetëm në vendimin e arsyetuar është njohur me analizën e trupit gjykues të Komisionit për llogaritë bankare të personit juridik, në pronë e administrim të vëllezërve të tij, në valutë të huaj. Duke konstatuar se mossjellja e këtyre akteve gjatë procesit të hetimit administrativ nuk mund t'i vihej në ngarkim e përgjegjësi subjektit, trupi gjykues konkludoi se pranimi i disa prej akteve të reja me ankimin përmbush testin e kërkuar nga ligji. Aktet që ishin pjesë e fashikullit të Komisionit, u bënë pjesë e analizës mbi të cilën u mbështet ky arsyetim.

11.3.2. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit u shpreh se i qëndron parashtrimeve dhe kërkoi nga Kolegji dhënien e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, ndryshimin e vendimit nr. 337, datë 18.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e tij në detyrën e gjyqtarit.

B. Mbi shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

12. Sikurse përmbledhur më sipër, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se procesi i rivlerësimit për të ka qenë i paragjykuar dhe vendimi i Komisionit i paracaktuar, pasi nuk janë marrë në konsideratë provat e sjella prej tij dhe meqenëse fillimisht hetimi përfundoi për një kriter të rivlerësimit, ndërsa kërkesa e tij për riçelje të hetimit administrativ u rrëzua me arsyetim sipërfaqësor. Nga ana tjetër, kërkesa e përsëritur për riçelje të hetimit iu pranua pa ndryshuar asnjë fakt apo rrethanë ose argumente shtesë. Konkretisht, subjekti potencon edhe sa vijon:

¹² Në kohën e shpalljes së vendimit nga Komisioni, në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

¹³ Aktet e referuara në seancë konsistojnë në 9 (nëntë) prej tyre, pasqyruar në poshtëshënimin 1 dhe 3 (tre), akte të paraqitura me parashtrimet përpara seancës së datës 19.03.2024, pasqyruar në poshtëshënimin 6.

¹⁴ "[L.] Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. 2. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, Kolegji i Apelit dhe vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të këtij ligji. Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit. [...]."

12.1. Kalimi i barrës së provës, riçelja e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera dhe zhvillimi i seancave dëgjimore janë zhvilluar vetëm në dukje, për të krijuar bindjen se procedura është respektuar; vendimi ishte marrë më parë. Komisioni fillimisht nuk e përfundoi hetimin administrativ për të tria kriteret, edhe pse kishte të përfunduar hetimin për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë profesional, por u mjaftua me një hetim sipërfaqësor, paragjykues, vetëm me një kriter, për të thirrur subjektin në seancë dhe për ta shkarkuar atë.

12.2. Më datë 06.02.2020, Komisioni i ka njoftuar rezultatet e hetimit administrativ vetëm për kriterin e pasurisë, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën për mbi 20 gjetje. Rreth 5 minuta pasi ai ka dërguar parashtrimet, prej rreth 37 faqesh, dhe dy fashikuj me prova, si dhe pa i shqyrtuar ato, Komisioni ka caktuar seancën dëgjimore, pa marrë parasysh kërkesën e tij për riçelje të hetimit administrativ. Kjo kërkesë është ripërsëritur në çelje të seancës dëgjimore dhe rrëzuar me një arsyetim sipërfaqësor.

12.3. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson të pabazuara në akte dhe në ligj këto pretendime të subjektit, qoftë për sa i përket përfundimit të hetimit administrativ për një kriter, si fillim, apo edhe të kohës gjatë së cilës Komisioni ka kryer procesin për rivlerësimin e tij. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

12.4. Së pari, kryerja e hetimit administrativ mbi bazën e një kriteri të vetëm parashikohet nga ligji nr. 84/2016, në pikën 2, të nenit 4¹⁵. Për rrjedhojë, në nivelin parimor, Komisioni ka diskrecionin që ta bazojë vendimin edhe mbi një kriter të vetëm. Në kushtet që moskalimi me sukses i secilit prej kriterëve veçmas mund të passjellë masën disiplinore të shkarkimit, kjo dispozitë përcakton edhe mundësinë e vendimmarrjes së Komisionit dhe Kolegjit bazuar në një kriter të vetëm, ndërsa për konfirmimin në detyrë nevojitet kalimi me sukses i të tria kriterëve, sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

12.5. Kolegji ka qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e tij, duke elaboruar në një sërë rastesh se kryerja e procesit të rivlerësimit mbi bazën e vetëm një kriteri, e parashikuar shprehimisht nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si mënyrë funksionimi që ka kaluar testin e kushtetutshmërisë dhe të përputhjes me garancitë e procesit të rregullt, sipas nenit 6 të KEDNj-së dhe vendimit të GjEDNj-së në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, përbën një rregullim ligjor që lejon efikasitetin, në funksion të interesit publik për shqyrtimin e çështjes brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm. Për pasojë, përfundimi i hetimit vetëm për një kriter, kur provat kanë arritur nivelin e provueshmërisë dhe rezultatet e hetimit janë të mjaftueshme për të bazuar vendimmarrjen, nuk mund të pretendohet paragjykim as i subjektit dhe as i procesit të tij të rivlerësimit.

12.6. Së dyti, administrimi i raporteve të DSIK-së dhe KLD-së, organe me rol ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar, nuk përbën shkak për të argumentuar se hetimi për kriterin e pastërtisë së figurës dhe atë profesional kishte përfunduar. Referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit, Komisioni dhe Kolegji, në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, realizojnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.¹⁶

¹⁵ “[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave. [...]”

¹⁶ Shih paragrafin 41 të vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, ku ndër të tjera referohet që: “[...] Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e Kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre

12.7. Nga ana tjetër, për sa i përket kohëzgjatjes së procesit apo arsyesimit të Komisionit për kërkesat e përsëritura të subjektit gjatë hetimit administrativ – përfshirë kërkesat për riçelje të hetimit – nga aktet në fashikull rezulton se, në datën 20.02.2020, krahas parashtrimeve për rezultatet e hetimit administrativ dhe provave bashkëlidhur, subjekti ka paraqitur kërkesë¹⁷ për riçeljen e hetimit administrativ në tërësi, dhe kryerjen edhe të vlerësimit për kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Subjekti ka kërkuar, ndërmjet të tjerave, pyetjen në cilësinë e dëshmitarit të disa personave, kryerjen e një ekspertimi kontabël, për analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve, me pretendimin se në raportin për rezultatet e hetimit administrativ mungon kjo analizë, kryerjen e një ekspertimi teknik - topografik dhe të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme për vendndodhjen dhe vlerën e pasurisë, si dhe administrimin e të gjitha provave shkresore bashkëlidhur parashtrimeve, pasqyruar në listën e inventarit (22 në total).

12.8. Me vendimin nr. 3, në datën 24.02.2020, Komisioni shprehet se ka disponuar të administrojë për shqyrtim të gjitha provat shkresore të paraqitura dhe t'i vlerësojë ato me objektivitet. Komisioni, po ashtu, është shprehur se, nëse me shpjegimet dhe provat do të provohet e kundërta e rezultateve të hetimit administrativ, do të vendosë lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit. Për kërkesën për thirrje si dëshmitarë të gjashtë individëve,¹⁸ Komisioni shprehet se subjekti ka depozituar deklarata noteriale të katër prej tyre, nëpërmjet të cilave ata kanë vetëdeklaruar lidhur me çfarë subjekti kërkon të provojë përmes dëshmime -- punësimin dhe të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni në Greqi apo për punësimin dhe të ardhurat nga puna e kryer në Itali nga znj. D. B. Po ashtu, faktet që do të dëshmonin dy personat e tjerë, të kërkuar të thirren si dëshmitarë, e konkretisht, periudhën gjatë së cilës vëllezërit e tij kanë jetuar e punuar në Greqi, nuk janë kontestuar në rezultatet e hetimit. Për rrjedhojë, Komisioni e ka vlerësuar të panevojshme thirrjen e këtyre personave, bazuar në parashikimet e nenit 49/6/a të ligjit nr. 84/2016. Së fundmi, Komisioni i ka vlerësuar të panevojshme kërkesat për ekspertim teknik-topografik dhe të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme (vendndodhjen dhe vlerën), pasi nuk ndikon në marrjen e vendimit, në kuptim të parashikimeve të nenit 49/6/a të ligjit nr. 84/2016, në kushtet që është administruar dokumentacioni i plotë nga organet publike për sa i përket pasurive, të regjistruara/që kanë qenë të regjistruara, në të cilat subjekti gëzon të drejta reale. Me vendimin nr. 4, datë 24.02.2020, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit, në datën 26.02.2020, në seancë dëgjimore.

12.9. Për sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit. Aktet në fashikuj provojnë se Komisioni ka shpjeguar arsyet dhe vlerën provuese të të gjitha akteve, duke shtjelluar edhe mënyrën se si do të veprohej në vijim me argumente, dhe bazuar në dispozitat ligjore të zbatueshme. Po ashtu, vendimi për seancën e radhës rezulton të jetë marrë katër (4) ditë pasi Komisioni është njohur me kërkesën e subjektit, dhe jo pas disa minutash, sikurse potencon ai.

12.10. Për sa i përket pranimit të kërkesës së disatë të subjektit për riçelje të hetimit administrativ për të tria kriteret, pa u ndryshuar asnjë shkak apo rrethanë, në referim të akteve të administruara në dosjet e Komisionit, trupi gjykues konstaton se me këtë objekt, përpos kërkesës së datës 20.02.2020, analizuar në paragrafët më lart, subjekti ka paraqitur kërkesë edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 26.02.2020, e njëjtë me atë të datës 20.02.2020, për të cilën Komisioni ishte shprehur me vendim në datën 08.03.2020 (përpara seancës dëgjimore të radhës, caktuar në datën 12.03.2020), dhe

kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse. [...]"

¹⁷ Kërkesa është administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 20.02.2020.

¹⁸ Ch. T. (shtetas grek), Sh. N., P. N., F. Ll., B. S. dhe D. B.

në datën 13.05.2020 (deri në këtë datë, seanca dëgjimore nuk ishte zhvilluar ende, si për shkak të disa kërkesave të subjektit për shtyrje të saj, e po ashtu edhe për shkak të situatës së pandemisë).

12.11. Referuar kërkesës së datës 08.03.2020, subjekti ndër të tjera shprehet se: *“Shkaqet e reja, bazuar në të cilat ju riparaqes kërkesën për riçelje të hetimit administrativ, janë si vijon: KPK, në analizën financiare që më ka vënë në dispozicion, nuk ka reflektuar asnjë pretendim apo shpjegim të dorëzuar nga ana ime që në datën 20.02.2020, edhe pse të administruar prej saj. Eksperti auditues ligjor D. A., bazuar në dokumentacionin që edhe ju keni pranuar se e keni administruar, ka dalë në konkluzione të tjera për disa vite të kundërta nga sa rezulton në analizën tuaj”*. Pas pasqyrit të konkluzioneve të ekspertit, subjekti riparaqet kërkesën për riçelje të hetimit, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, e konkretisht (i) për administrimin e raportit të audituesit ligjor D. A., datë 02.03.2020; (ii) rikryerjen e ekspertimit kontabël me ekspert të pavarur, për analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke pasur parasysh mendimin e marrë nga eksperti privat, pasi nga përmbajtja e analizës financiare eksperti i konsultuar prej Komisionit ose nuk ka njohuritë përkatëse, ose ka vepruar qëllimisht për dëmtimin e interesave të tij; (iii) marrjen/administrimin e provave të reja për të kundërshtuar rezultatet e hetimit paraprak. Në përfundim, subjekti konkludon *“riçeljen e hetimit administrativ në kriterin e pasurisë, për marrjen e provave shkresore”*.

12.12. Komisioni ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë dhe pranimin e kërkesës për administrimin dhe shqyrtimin e provave të paraqitura me *email*-in e datës 08.03.2020. Për sa më sipër, pavarësisht se kërkesa e datës 08.03.2020 ka objekt *“riçeljen e hetimit administrativ për vlerësimin e pasurisë dhe riçeljen e hetimit administrativ duke kryer vlerësimin edhe për kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale”*, në përmbajtje, subjekti ka shtjelluar argumentet dhe pretendimet e tij vetëm për hetimin administrativ lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, duke kërkuar riçelje të hetimit vetëm për këtë kriter, bazuar në provat e reja që paraqiteshin prej tij.

12.13. Referuar kërkesës së datës 13.05.2020, subjekti shprehet: *“Ju riparaqes kërkesën për riçeljen e hetimit në të tria kriteret për këto arsye: hetimi administrativ vetëm me një kriter, në kushtet kur disponohen raportet dhe dokumentacioni i nevojshëm për dy kriteret e tjera, përveçse është paragjykes, është i mangët dhe i paplotë”*. Më tej, duke referuar përgjigjet shkresore të marra nga DSIK-ja dhe KLGJ-ja, me të cilat është informuar për dërgimin e raporteve përkatëse në Komision, subjekti shprehet se: *“Meqenëse edhe këto dy kritere janë të hetuara, disponohen raportet përkatëse nga ana juaj, si dhe është marrë dokumentacioni lidhur me to, nuk gjej asnjë arsye logjike (dhe më pak juridike) se përse nuk çelet hetimi administrativ edhe për këto dy kritere”*.

12.14. Në përfundim të analizës si më sipër, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara pretendimet e subjektit për të ndërlidhur shkakun e ankimit për paragjykim dhe paracaktim të vendimit, me disponimin që i ka bërë Komisioni kërkesave të tij për riçelje të hetimit administrativ. Rrethanat faktike dhe ligjore tregojnë qartësisht të kundërtën e sa pretenduar prej tij. Konkretisht: (i) Dy prej kërkesave, të datave 20.02.2020 dhe 26.02.2020, janë bërë pothuajse në të njëjtin moment procedural, përpara dhe në nisje të seancës dëgjimore, për rrjedhojë, nuk kishte asnjë rrethanë që të motivonte paraqitjen e kërkesës së dytë, përpos që Komisioni ishte shprehur me vendimin e ndërmjetëm për kërkesën e parë, duke argumentuar rrëzimin e saj. (ii) Me kërkesën e tretë, e datës 08.03.2020, pavarësisht objektit, kërkohej riçelje e hetimit administrativ vetëm për kriterin e pasurisë, e disponuar prej Komisionit me vendim të ndërmjetëm për sa kërkuar. (iii) Kërkesa e katërt, e datës 13.05.2020, disponuar prej Komisionit me vendim të ndërmjetëm, duke riçelur hetimin administrativ për të tria kriteret, për sa në përmbushje të barrës së provës, përpos me provat e paraqitura në datën 20.02.2020,

edhe me provat e paraqitura në datën 08.03.2020, situata kishte ndryshuar, rezulton të jetë e vetmja që të konsiderohet e bazuar dhe e paraqitur në momentin e duhur procedural.

12.15. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka disponuar kërkesat e subjektit për riçelje të hetimit administrativ për të tria kriteret, bazuar në ligj e në prova, dhe jo për shkak të riparaqitjes disa herë radhazi të kërkesave dhe, pa ndryshuar asnjë fakt apo rrethanë, ka vendosur pranimin e tyre, sikundër shprehet subjekti. Duke gjykuar *a contrario* sipas pretendimit të subjektit për paragjykim prej Komisionit të tij dhe të çështjes së tij, manifestuar në mbylljen e hetimit administrativ me një kriter, Komisioni do të kishte vijuar të dëshmonte “paragjykimin” e tij, duke mos çelur hetimin administrativ për dy kriteret e tjera. Për rrjedhojë, në të gjitha këndvështrimet, pretendimet e subjektit vlerësohen nga trupi gjykues të pabazuara në fakte.

12.16. Trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson të pabazuara edhe pretendimet e tjera me natyrë procedurale, sikurse që në seancat dëgjimore pas riçeljes së hetimit administrativ, u relatuan gjetjet e raportit për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht të njoftuar atij në datën 06.02.2020, pa iu vlerësuar asnjë provë apo pretendim të tij apo që të gjitha hapat procedurale të ndjekura nga Komisioni -- kalimi i barrës së provës, zhvillimi i seancave dëgjimore, riçelja e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera të rivlerësimit -- janë zhvilluar vetëm në dukje.

12.17. Praktika e ndjekur nga Komisioni nuk bie në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi lidhur me procedurën e kryerjes së një hetimi administrativ, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. *Së pari*, qëllimi i seancës dëgjimore është të dëgjohet subjekti i rivlerësimit lidhur me barrën e provës që i ka kaluar, përfshirë edhe diskutimin e çdo akti të dorëzuar në cilësinë e provës, që provon fakte përkundrejt gjetjeve të Komisionit¹⁹. *Së dyti*, vlerësimi i Komisionit lidhur me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në formë të shkruar me parashtrimet, si edhe verbalisht gjatë seancës dëgjimore, trajtohet në vendimin e arsyetuar, në një rubrikë të veçantë për shpjegimet e dhëna dhe provat e depozituara nga subjekti, në drejtim të çështjeve të marra në analizë nga Komisioni. Në çështjen në shqyrtim, Komisioni e ka sqaruar subjektin disa herë, në vendimet e ndërmjetme dhe në seancë dëgjimore, se shqyrtimi dhe vlerësimi i provave të paraqitura prej tij do të bëhej pas seancës dëgjimore, sikundër dëshmohet se ka ndodhur.

12.18. Në kundërshtim me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se raporti për rezultatet e hetimit administrativ duhet të reflektonte shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni e ka përmbushur detyrimin ligjor duke vlerësuar se provat e grumbulluara kishin nivelin e provueshmërisë, në përputhje me përcaktimet e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Vlerësimi paraprak, sipas parashikimeve të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i shërben qëllimit për të arritur në përfundimin se provat që Komisioni dispononte, kishin nivelin e provueshmërisë, dhe vlerësimi përfundimtar i tyre bëhet në përfundim të procesit, në momentin e vendimmarrjes, bazuar në nenin 58, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

12.19. Lidhur me pretendimin se paragjykimi ndaj tij rezulton edhe nga fakti se në këtë proces është hetuar çdo person “që ka kontaktuar me të”, dhe se është shkarkuar edhe për informalitetin e një personi me të cilin ka hyrë në marrëdhënie kontraktore, ndërkohë që takimet me të kanë qenë të pakta, e ka marrë informacion vetëm nëse ishte i përfshirë në veprimtari kriminale, pasi verifikoi aktet e

¹⁹ Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 88, “Ushtrimi i të drejtës për t’u dëgjuar” parashikon “Palët, në ushtrimin e së drejtës për t’u dëgjuar, mund të paraqesin komente edhe për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës”.

fashikullit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim nuk është i bazuar. Verifikimi që Komisioni ka bërë në burime të hapura, në faqen zyrtare të QKB-së për z. Sh. A., ka ardhur si pasojë e faktit që, për të konfirmuar prezencën e tij në momentin e nënshkrimit të kontratës së kalimit të të drejtave për apartamentin, subjekti ka depozituar vetëm kartela dentare për shërbime të pretenduara të kryera prej këtij tij, pa dokumentacion për klinikën apo punësimin e tij. Në rrethanat konkrete që rezultojnë nga aktet, pretendimi se Komisioni ka kryer *hetim* ndaj z. Sh. A., është i pabazuar. Për më tepër, në vendimin objekt shqyrtimi, në asnjë rast, Komisioni nuk shprehet se informaliteti i shtetasit Sh. A. të ketë pasur pasojë në procesin e rivlerësimit të subjektit.

12.20. Pretendimi i subjektit, se shkarkimi i tij nga detyra është haptazi i pambështetur në ligj, pasi pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 kërkon plotësimin kumulativ të kriterëve, është po ashtu i pabazuar, sikurse elaboruar gjerësisht dhe në mënyrë shteruese në vendime të mëparshme të Kolegjit. Pa përsëritur ato arsyetime, trupi gjykues çmon vetëm të ritheksojë se koncepti i deklaramit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, përfshin qoftë deklaramin e pasurisë, edhe atë të figurës, ndërsa këto dy kritere rregullohen nga pika të ndryshme të të njëjtit nen, të cilat janë autonome nga njëra-tjetra. Po ashtu, vlerësimi i pasurisë gjen zbërthim në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ndërsa deklarami i figurës gjen zbërthim në nenin 38 të të njëjtit ligj. Parashikimet e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si të pavarura, vlerësimi i të cilave, në kuadër të prodhimit të pasojave sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u nënshtrohet parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është tashmë i mirelaboruar si i pabazuar.

12.21. Pretendimet e subjektit për mos shqyrtim dhe mos vlerësimin të provave të paraqitura prej tij, për kohëzgjatje të hetimit administrativ apo për seanca dëgjimore formale, për shkak të paragjyqimit e paracaktimit të vendimit, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson të pabazuara.

Së pari, pretendimi për mos referimin e provave dhe qëndrimeve të tij në vendim, nuk qëndron në tërësi. Në vendimin objekt shqyrtimi, për çdo pasuri të analizuar, në rubrikën që pasqyron të dhënat e hetimit të kryer nga Komisioni janë të transpozuar deklaramet e subjektit përmes pyetësorëve. Po ashtu, në rubrikë të veçantë pasqyrohet qëndrimi dhe provat e paraqitura për dërgimin të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht, i cili duket se nuk është një riprodhim literal i deklarameve të tij, dhe në vijim vlerësimi i Komisionit për to. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni, jo domosdoshmërisht, ka detyrë të kryejë pasqyrime literale të asaj që deklarojnë subjektet; madje, ndonjëherë kjo është e pamundur dhe e pakuptimtë. Ajo që ka rëndësi është moscenimi i anës substanciale të deklarameve dhe mosnxjerrja e tyre jashtë kontekstit. Në rastin në shqyrtim, nuk konstatohet që kjo të ketë ndodhur. Lidhur me mos referimin në vendim të raportit të audituesit ligjor D. A., i hartuar për të dhënë mendim të specializuar mbi situatën financiare, balancën e fondeve para fillimit të ushtrimit të detyrës nga viti 2009 – 31.12.2016, trupi gjykues nuk konstaton asnjë cenim të së drejtës së subjektit. Në vendim, lidhur me pasurinë për të cilën janë konstatuar problematika, apartamentin e banimit në rrugën “{***}”, në Tiranë, konkretisht huan e marrë nga vëllai, P. N., gjendet referencë në raportin e këtij eksperti, të datës 18.02.2020, të hartuar mbi pyetje të z. Sh. N. për shoqërinë “{***}” ShPK, ndër të tjera, në paragrafët 63 dhe 64 e pjesët përbërëse të tyre, përfshirë edhe në poshtëshënimin përkatës.

12.21.1. *Së dyti*, pretendimi për kohëzgjatje të procesit apo atribuuar atë paragjyqimit të Komisionit është i pabazuar. Komisioni e ka nisur hetimin administrativ në datën 24.01.2019 dhe e ka përfunduar

në datën 05.02.2020. Në vijim, tri seanca janë shtyrë me kërkesë të subjektit dhe për t'i dhënë atij kohë shtesë. Konkretisht: seanca dëgjimore e datës 26.02.2020 është shtyrë për t'i garantuar subjektit të drejtën e mbrojtjes efektive, duke pranuar kërkesën e tij për dhënie kohe shtesë për t'u shprehur lidhur me analizën e detajuar financiare, kërkesat e datave 02.03.2020 dhe 11.03.2020, përfshirë edhe për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 apo për shkak të kërkesave të subjektit, të datës 23.02.2020, për shtyrje të afatit për t'u njohur me dosjen, të datës 20.07.2020, për caktim në datë të mëvonshme të seancave dëgjimore, për shkak të pamundësisë së paraqitjes për shkaqe shëndetësore, si dhe pezullimit të procesit të rivlerësimit, bazuar në shkresat e Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilat është njoftuar largimi i subjektit jashtë vendit për arsye shëndetësore dhe kthimi i tij,²⁰ kërkesës së datës 20.11.2020, për caktimin e seancës dëgjimore pas riaftësimit të tij, pasi përfaqësuesit ligjorë të kërkuar prej Komisionit për t'u caktuar prej subjektit, me qëllim vijimin e procesit, nuk morën përsipër mbrojtjen e tij. Në datën 30.12.2020, subjekti ka komunikuar se ka zgjedhur përfaqësuesin e tij ligjor të pajisur me prokurën e posaçme dhe në datën 08.01.2021 ka konfirmuar pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të caktuar në datën 14.01.2021. Sa më sipër, për kohëzgjatjen e hetimit administrativ, të diktuar nga shkaqe objektive, si dhe kërkesat e vetë subjektit, pretendimi i tij për t'ia atribuar paragjykimin të çështjes prej Komisionit, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar.

12.21.2. *Së treti*, pranimi i kërkesës për dhënie kohe shtesë për t'u shprehur lidhur me analizën e detajuar financiare, në seanca dëgjimore të zhvilluara pas njohjes me provat e administruara prej Komisionit duke marrë kopje të tyre, referuar procesverbaleve të seancave dëgjimore ku konstatohet paraqitja pa asnjë kufizim e parashtrimeve, shpjegimi i provave në përgjigje të barrës së provës, si edhe mendimit në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, tregon se subjektit i është respektuar e drejta për t'u dëgjuar, në respektim të plotë të parimit të kontradiktoritetit.

12.22. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit, pasi nuk është shprehur sa ishte pamjaftueshmëria e huadhënësit, trupi gjykues, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit në vendimmarrje të mëparshme,²¹ vëren se mungesa e një vlere financiare, ndonëse paraqet rëndësi në kuptimin e arsytimit mbi të cilin është bazuar masa disiplinore e shkarkimit, jo domosdoshmërisht mund të përbëjë *a priori* shkak për ta konsideruar të paragjykuar vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet

²⁰ Shkresa nr. {***}, datë 15.10.2020, e Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila bazuar në kërkesën e subjektit, ka njoftuar Komisionin për largim jashtë vendit të subjektit për kurim. Po nga kjo Gjykatë, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.11.2020, Komisioni është njoftuar për kthimin e subjektit të rivlerësimit në Shqipëri. - Më datë 13.11.2020, me postë elektronike, Komisioni ka rikujtuar subjektin e rivlerësimit se ka pezulluar procesin e rivlerësimit ndaj tij dhe mbetet në pritje të njoftimit prej tij për vijimin e procesit. - Më datë 16.11.2020, me postë elektronike, subjekti ka bërë me dije kthimin e tij në Shqipëri më datë 06.11.2020, sugjerimin e mjekëve për të paktën 2 muaj regjim shtrati, izolim dhe pa kontakte me të tretë, dhe se është në proces verifikimi dhe njohje nga KM-CAP të dokumentacionit të lëshuar nga spitali ku ka marrë trajtim mjekësor, dhe ka përcjellë dokumentacion mjekësor të përkthyer nga përkthyes i licencuar: raport epikrize, raport për tregimin e gjendjes, kontrolli BT i mushkërisë me rezonancë të lartë. - Në datën 17.11.2020, Komisioni ka njoftuar subjektin, me postë elektronike, se në vlerësim të gjendjes së tij në tërësi ka vendosur të zhvillojë seancën dëgjimore në datë, 25.11.2020, duke i dhënë mundësinë e përgatitjes së parashtrimeve në lidhje me dokumentacionin e administruar gjatë riçeljes së hetimit administrativ, e në rast pamundësie personale, për të ushtruar të drejtat e parashikuara nga neni 64 i Kodit Civil për caktimin e një përfaqësuesi ligjor, dhe përfaqësimit në seancë dëgjimore përmes këtij përfaqësuesi, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative. Në përfundim, Komisioni shprehet se nuk do të lejojë në vijim zvarritjen e procesit të rivlerësimit, se afati për depozitimin e provave dhe shpjegimeve, nëse shihen të arsyeshme, është deri në datën 25.11.2020, dhe se rezervon të drejtën të hetojë procedurat ligjore/mjekësore të lëshimit të raporteve (përmes kërkesës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë), dhe t'i kërkojë Këshillit të Lartë Gjyqësor të marrë masa për ekzaminimin e gjendjes së tij shëndetësore nga një mjek i caktuar prej tyre.

²¹ Shih ndër të tjera, vendimet e Kolegjit nr. 33/2022 (JR) dhe nr. 35/2022 (JR).

nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni.

13. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të një procesi dhe vendimmarrje të paragjykuar e të paracaktuar, mosgarantimit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar në mënyrë efektive, në përputhje dhe respektim të parimeve të ligjshmërisë, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, janë të pabazuara.

D. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

14. Pasi ka hetuar për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka konstatuar probleme për një nga pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur. Në përfundim, masa disiplinore e shkarkimit ka për fokus konkluzionet e Komisionit për *apartamentin* me sipërfaqe 84.6 m², ndodhur në kompleksin “{***}”, rruga “{***}”, në Tiranë. Konkretisht, Komisioni ka konstatuar që subjekti i rivlerësimit është në kushtet e *mungesës* së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer në datën 29.05.2012, për kalimin e të drejtave të pronësisë mbi apartamentin në fjalë dhe që ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, nisur nga dyshimet për vërtetësinë e marrëdhënies juridike -- nënshkrimin e një kontrate kalimi pronësie për këtë pasuri në mungesë të njëjës palë.

14.1. Subjekti i rivlerësimit në ankim parashtron se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar, duke parashtruar argumente për secilin prej përfundimeve, të cilat janë pasqyruar më lart në këtë vendim, në pjesën III të tij, shkaqet e ankimit, në pikat A, B dhe C. Në thelb të pretendimeve, subjekti argumenton se jo vetëm që ka provuar prezencën, si dhe shprehjen e lirë të vullnetit prej z. Sh. A., në nënshkrimin përpara noterit të kontratës për kalimin e të drejtave, por edhe që fuqia provuese e këtij akti përcaktohet drejtpërdrejt nga Kodi i Procedurës Civile dhe nuk është në diskrecionin e organeve të rivlerësimit. Për sa i përket konstatimit për mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer në datën 29.05.2012, në vijim të së cilës ai ka fituar të drejtat për këtë pasuri (me kontratën e *kalimit të të drejtave*), subjekti i rivlerësimit i fokusoi argumentet e tij në këto aspekte: (i) mjaftueshmërinë e të ardhurave të huadhënësit për të mundësuar huan prej 5.500.000 lekësh me burime të ligjshme financiare, duke renditur si të tilla gjendjen e arkës së shoqërisë “{***}” ShPK, në datën 29.05.2012, në shumën 5.857.374 lekë, të mundshme për t'u përdorur nga huadhënësi në cilësinë e ortakut *të vetëm* të shoqërisë, të ardhurat e huadhënësit nga pagat dhe dividendi, të buruara nga aktiviteti i tij tregtar; (ii) detyrimin sipas parashikimeve të kuadrit kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit për të provuar *vetëm* ligjshmërinë e burimet financiare të huadhënësit për krijimin e shumës së huas; (iii) transaksionet në dollarë dhe euro të shoqërisë “{***}” ShPK, të cilat nuk kanë pasur burim gjendjen e arkës së shoqërisë, por huan nga të tretët, sipas dokumentacionit të paraqitur në Kolegj.

14.2. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe mori në shqyrtim pretendimet e subjektit dhe shpjegimet e tij në seancë gjyqësore publike, si dhe analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin që subjekti i rivlerësimit rezulton i besueshëm edhe në kontrollin e kriterit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në vijim.

14.3. Së pari nga aktet në fashikull rezultojn e dokumentuar si vijon:

a. Në deklaratën *vetting*, subjekti e ka deklaruar pasurinë “apartament me sipërfaqe 84.6 m²”, me adresën përkatëse, me vlerë 40.000 euro, pjesë takuese 100%, për të cilin ka marrë të drejtat si porositës, në bazë të kontratës noteriale (nr. {***/***/}), datë 29.05.2012, të titulluar “Kontratë kalim të drejtash (dorëzim apartamenti)”, i paregjistruar. *Burim krijimi* deklarohen: 5.000 euro kursime personale ndër vite, 35.000 euro pjesë e huas marrë nga të tretët dhe kredi bankare e vitit 2012. Në rubrikën e *detyrimeve financiare*, subjekti deklaroi se me kontratën noteriale të huas, datë 04.06.2012, ka marrë hua nga vëllai shumë 5.500.000 lekë, e cila është përdorur për blerjen e apartamentit më datë 29.05.2012, si porositës. Kontrata e huas u revokua në bazë të aktit noterial nr. {***/***/}, datë 22.06.2012, pasi kredia nuk u akordua; me të njëjtin person/vëllain u lidh kontrata tjetër noteriale (nr. {***/***/}), datë 22.06.2012, për huadhënie të shumë 5.500.000 lekë, për prenotimin e apartamentit. Huaja do të shlyhej si vijon: kësti *i parë*, prej 3.700.000 lekësh, në momentin e akordimit të kredisë nga ProCredit Bank, kredi e aprovuar me kontratën {***/***/}, datë 28.06.2012, likuiduar vëllait në datën 02.07.2012; *kësti i dytë* prej 1.800.000 lekësh do të shlyhej pas shitjes së automjetit – shitur me kontratën nr. {***/***/}, datë 03.12.2004, ku u bë likuidim pjesërisht nëpërmjet RFZ Bank, në shumë 1.080.000 lekë, në datën 05.12.2014. Shuma prej 220.000 lekësh likuiduar në datën 26.12.2014, nëpërmjet Raiffeisen Bank, me të ardhura nga kontrata e qirasë nr. {***/***/}, datë 24.09.2012. Shuma prej 200.000 lekësh likuiduar në datën 14.12.2015, nëpërmjet Raiffeisen Bank, me të ardhura nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Deri në datën 27.01.2017 është likuiduar në shumë 5.200.000 lekë, mbetet për t’u shlyer diferenca prej 300.000 lekësh.

- Me kontratën {***/***/}, datë 28.06.2012, është akorduar kredia me kusht dhe hipotekim nga ProCredit Bank, në shumë 3.700.000 lekë, e marrë për qëllim likuidimi të huas së marrë me kontratën {***/***/}, datë 22.06.2012, dhe për kontratën {***/***/}, datë 29.05.2012 (apartamenti). Subjekti deklaroi kushtet e kredisë dhe shumë e mbetur pashlyer, prej 3.236.607 lekësh.

Në formularin “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti deklaroi huamarrje nga vëllai P. N., me burim kontratë kredie me kufi nr. {***/***/}, datë 04.03.2011, me burim të ardhurat si ortak i personit juridik “{***/***/}” ShPK.

b. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor justifikues si vijon:

- Kontratë kalim të drejtash (dorëzim apartamenti) nr. {***/***/}, datë 29.05.2012, lidhur mes dhe Sh. A./porositës i parë, subjektit të rivlerësimit/porositës i dytë dhe shoqërisë “{***/***/}” ShPK/shoqëria ndërtuese. Sipas kontratës, Sh. A. heq dorë nga të drejtat që i linden nga kontrata e porosisë nr. {***/***/}, datë 14.04.2007, lidhur me shoqërinë ndërtuese “{***/***/}” ShPK, për apartamentin me sipërfaqe 84.6 m², në pronësi të shoqërisë. Të drejtat e pronësisë i kalojnë subjektit të rivlerësimit, vlera totale e blerjes së apartamentit është 40.000 euro, e likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale, nga këto 5.000 euro blerësi i ka nga kursimet personale në vite dhe 35 000 euro i ka marrë hua pa kamatë nga vëllai, P. N., deri në momentin e akordimit të kredisë nga banka (neni 2, “vlefte dhe mënyra e pagesës”). Bashkëlidhur kontratës si më sipër është deklarata e z. R. A., datë 29.05.2012, me shkrim dore, që deklaroi se: “*ka marrë për llogari të Ç., i cili shet me këtë kontratë ap. nr. {***/***/}, hyrja 1+1, shumë 40,000 euro, e cila u likuidua totalisht. Marrësi i lekëve R. A.*”. Në pjesën e sipërme të kësaj deklarate është kopja e kartës së

identitetit të z. Sh. A. Bashkëlidhur, kontratë porosie nr. {***/{***}}, datë 14.04.2007, me porositës Sh. A. dhe sipërmarrës shoqëria “{***}” ShPK.

- Kontratë huaje nr. {***/{***}}, datë 4.06.2012, me huadhënës P. N., huamarrës Bib Ndreca, për shumën e huas 5.500.000 lekë, me qëllim blerjen e banesës sipas kontratës nr. {***/{***}}, datë 29.05.2012, dhe revokim të kësaj kontrate, pa kushte, me nr. {***/{***}}, datë 22.06.2012.
- Kontratë huaje nr. {***/{***}}, datë 22.06.2012, me huadhënës P. N., huamarrës Bib Ndreca, për shumën e huas 5.500.000 lekë, me qëllim blerjen e banesës sipas kontratës nr. {***/{***}}, datë 29.05.2012, duke përcaktuar shlyerjen e saj me dy këste.
- Kontratë për kreditim me kusht dhe hipotekimi nr. {***/{***}}, datë 28.06.2012, kreditor ProCredit Bank, kredimarrës subjekti dhe bashkëshortja, A. Ll., vlera e kredisë 3.700.000 lekë, bashkëlidhur praktika përkatëse. Qëllimi i kredisë përcaktohet për blerje shtëpie.
- Lëvizje e llogarisë bankare të z. Bib Ndreca, nga ProCredit Bank, e kredituar në datën 29.06.2012, në shumën 3.700.000 lekë, nga disbursimi i kredisë, shumë e debituar në llogarinë e z. P. N., në datë 2.07.2012, me përshkrimin “kthim borxhi”.
- Lëvizje e llogarisë bankare të z. Bib Ndreca, nga Raiffeisen Bank: (i) datë 05.12.2014, për pagesën e brendshme të shumës 1.080.000 lekë, në llogarinë e z. P. N., me përshkrimin “sipas kontratës së huas nr. {***/{***}}, datë 22.06.2012”; (ii) datë 14.12.2015, për depozitimin e shumës 200.000 lekë, në llogarinë e z. P. N., me përshkrimin “sipas kontratës së huas nr. {***/{***}}, datë 22.06.2012”; (iii) datë 26.12.2014, për depozitimin e shumës 220.000 lekë, në llogarinë e z. P. N., me përshkrimin “sipas kontratës së huas nr. {***/{***}}, datë 22.06.2012”.

c. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012, subjekti deklaroi se, në bazë të kontratës noteriale datë 29.05.2012, për kalim të drejtash, cilësuar si kontratë *paraprake blerjeje*, ka blerë apartamentin (me sipërfaqe 84.6 m²), që është në pronësi të shoqërisë ndërtuese “{***}”. Apartamenti ka qenë i porositur me kontratë noteriale të datës 14.04.2007, nga Sh. A. Ky i fundit hoqi dorë nga kjo e drejtë kundrejt çmimit 40.000 euro. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: në momentin e hartimit të kontratës, shuma prej 35.000 euro, marrë nga vëllai, P. N. dhe 5.000 euro, kursime vetjake ndër vite. Subjekti, po ashtu, ka deklaruar edhe që kontrata noteriale e huas, që mban datën 22.06.2012, mes tij dhe vëllait, P. N., ka pasur për qëllim huadhënien pa interes e kamatëvonesë të shumës 5.500.000 lekë. Nga kjo shumë, 3.700.000 lekë do të shlyheshin me akordimin e kredisë nga ProCredit Bank, tërhequr në datën 29.06.2012 dhe 1.800.000 lekë do të shlyheshin në momentin e shitjes së automjetit në pronësi, deri në datën 30.12.2017. Në bazë të kontratës së kredisë nr. {***/{***}} është marrë kredia në shumën 3.700.000 lekë dhe është shlyer kësti i parë i huas.

d. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën e *detyrimeve financiare*, subjekti deklaroi gjithë sa më sipër.

e. Në deklaratat periodike vjetore të pasurisë për vitet 2013 – 2016, subjekti ka deklaruar në rubrikën e *detyrimeve financiare* shlyerjen e pjesëve të mbetura të huas ndaj vëllait, përkatësisht nuk ka ndryshime, shlyerjen e 1.300.000 lekëve, me të ardhurat nga shitja e automjetit, të ardhurat nga qiraja dhe paga e bashkëshortes, shlyerjen e 200.000 lekëve, me të ardhurat nga paga e tij dhe paga e bashkëshortes, detyrimi i mbetur 300.000 lekë dhe nuk ka shlyer asnjë shumë.

14.4. Nga analiza e akteve të referuara më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit provoi bindshëm, me dokumentacion të kohës së krijimit të pasurisë, marrëdhënien e huas së krijuar

mes tij dhe personit tjetër të lidhur/vëllait, në vlerën 5.500.000 lekë. Në këtë drejtim, trupi gjykues vlerësoi edhe koherencën e deklarimeve dhe detajet e tyre në kohën e krijimit të pasurisë, konfirmuar edhe me deklaratën *vetting*. Në të njëjtën linjë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi edhe konsistencën në krijimin e marrëdhënieve juridike dhe revokimin apo modifikimin e tyre me të njëjtën formë. Konkretisht, huaja mes subjektit dhe vëllait, jo vetëm që ka lënë gjurmë nëpërmjet një akti noterial, në vitin 2012, është revokuar duke ndjekur të njëjtën formë të dokumentuar dhe, për pasojë, ka lënë gjurmë të kohës dhe sjellë veprimet në koherencë me momentin dhe shumën e përfituar me kredi bankare dhe detyrimet që do të passillte ajo.²² Edhe veprimet e përshkruara në kontratën për kalimin e të drejtave të apartamentit, e konkretisht, huaja e marrë nga vëllai, P. N., si një nga burimet e krijimit të shumës prej 40.000 euro, gjen pasqyrim në aktet e kohës. Pas disbursimit të kredisë prej 3.700.000 lekësh, në datën 29.06.2012, nga ProCredit Bank, në llogarinë e subjektit, ajo rezultoi e transferuar nëpërmjet bankës në favor të huadhënësit, me përshkrimin “kthim borxhi”.

14.5. Këto veprime të kohës, sikurse edhe përshkrimi i tyre i detajuar nga subjekti, provojnë jo vetëm marrëdhënien e huas, por edhe veprimet e subjektit për shlyerjen e detyrimeve. Në këtë aspekt, trupi gjykues mban në konsideratë edhe shlyerjen e kredisë bankare prej subjektit ndër vite, sikundër edhe shlyerjen pjesore të këstit të dytë të huas. Të gjitha këto veprime kanë lënë gjurmë të kohës të pakontestueshme, të cilat Komisioni duhet t'i kishte mbajtur në konsideratë. Së fundmi, marrëdhënia e huas dhe mënyra se si ajo është shlyer përkojnë me përshkrimin në deklaratën *vetting*, sikurse edhe në deklaratat periodike vjetore të referuara më lart, për dinamikën në të cilën është krijuar, zhvilluar e shlyer dhe detyrimet që ka passjellë huaja, të cilat janë në harmoni me aktet, për shkak të vlerës provuese që ato marrin në procesin e rivlerësimit kalimtar²³.

14.6. Nga aktet e administruara në fashikull rezultoi se personi tjetër i lidhur, huadhënësi P. N., ka disponuar një sasi të konsiderueshme likuiditetesh në cilësinë e ortakut të vetëm të personit juridik në emër të tij, “{***}” ShPK. Ndër to, likuiditetet në arkën e shoqërisë, sipas dokumentacionit të administruar, mundësonin huadhënien në vlerën 5.500.000 lekë, në datën 29.05.2012, edhe pa përfshirë të ardhurat individuale të fituara prej tij, që rezultojnë nga aktet. Nga ana tjetër rezultoi se huadhënësi ka ndërthurur interesat e tij financiare individuale me ato në emër të shoqërisë, fakt i cili rezultoi edhe nga shpjegimet e subjektit.

14.7. *Së pari*, trupi gjykues konstatoi se subjekti nuk ka ndryshuar deklarin e tij gjatë procesit për burimet financiare që i kanë shërbyer huadhënësit për të financuar huan. Subjekti, në mënyrë konsistente, është shprehur për të ardhurat e tij (personit tjetër të lidhur/vëllait, nga aktiviteti tregtar i

²² Në datën 04.06.2012, me kontratë huaje nr. {***/**}, z. P. N. deklaroi se ka dhënë hua jashtë zyrës noteriale shumën 5.500.000 lekë, për të cilën subjekti deklaroi se e ka marrë të plotë në dorë, në datën 29.05.2012, për të paguar banesën e blerë në këtë datë, me kontratën nr. {***/**}, notere L. K. Në kontratë parashikohet se huaja jepet me afat kohor likuidimi me këste: (i) kësti i parë, prej 4.000.000 lekësh, do të shlyhet në momentin e marrjes së kredisë nga BKT-ja; (ii) kësti i dytë, në shumën 1.500.000 lekë, do të likuidohet pas daljes në marrëdhënie pune të bashkëshortes, znj. A. Ll, i cili përcaktohet për t'u paguar pa afate të vënë në kohë e këste deri në datën 30.12.2017. Në datën 22.06.2012, me nr. {***/**}, kontrata e huas së sipërcituar është revokuar nga palët, pa asnjë kusht e detyrim të ndërsjellë, me arsyen se BKT-ja nuk akordoi kredinë në favor të huamarrësit. Po në datën 22.06.2012, palët kanë lidhur kontratën e huas nr. {***/**}, sipas së cilës z. P. N. deklaroi se ka dhënë hua shumën 5.500.000 lekë, për të cilën subjekti deklaroi se e ka marrë në datën 29.05.2012, për të paguar banesën e blerë në këtë datë, me kontratën nr. {***/**}, notere L. K. Në këtë kontratë huaje parashikohet se huaja jepet me afat kohor likuidimi me këste: (i) kësti i parë, në shumën 3.700.000 lekë, do të shlyhet në momentin e akordimit të kredisë në favor të huamarrësit në ProCredit Bank dhe (ii) kësti i dytë, në shumën 1.800.000 lekë, do të likuidohet pas shitjes së mjetit tip “Benz”, me targë {***}. Gjithashtu, në kontratë parashikohet se këto këste do të likuidohen deri në datën 30.12.2017.

²³ Ligji nr. 84/2016, në nenin 32, në pikën 5, parashikon: “[5.] Deklarimet e interesave private dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”.

shoqërisë dhe ato personale nga ky aktivitet, përfshirë edhe overdraftin). Konkretisht, në pyetësozin nr. 2, subjekti deklaroi “si burim për të ardhurat, vëllai më ka bërë me dije se është përdorur llogaria Kontratë Kredie me Kufi, {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2011, të ardhurat si ortak i personit juridik “{***}” ShPK, dhe se shumën e huas prej 5.500.000 lekësh, të dhënë *cash* nga vëllai, e ka përdorur pjesërisht për blerjen e apartamentit, konvertuar në euro, ndërsa diferencën e ka përdorur për punime shtesë në apartament dhe mobilimin e tij, si dhe për shpenzimet noteriale dhe të marrjes së kredisë.

14.8. Në përgjigje të barrës së provës, në vijim të konstatimit të Komisionit “duket se kredia me kufi (overdrafti) e marrë nga shoqëria ‘{***}’ ShPK, në datën 04.03.2011, në Raiffeisen Bank, nuk mund të ketë shërbyer si burim i të ardhurave të vëllait, P. N., të pretenduara se kanë shërbyer për dhënien e huas në datën 29.05.2012”, subjekti ka paraqitur si provë raportin e audituesit ligjor D. A.²⁴ Po ashtu, subjekti parashtron se është informuar se, për efekt të mbarëvajtjes së biznesit -- *blerje/shitje sipas aktivitetit që ushtronte* -- vëllai, P. N., duhet të mbante gjendje likuiditeti në çdo moment.

14.9. Po në përgjigje të barrës së provës, në prapësim të konstatimit të Komisionit, se personi tjetër i lidhur *nuk* ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shumën prej 5.500.000 lekësh, deklaruar si e dhënë hua në datën 29.05.2012,²⁵ subjekti ka prapësuar se vëllai i tij ishte ortak i vetëm i shoqërisë dhe ka potencuar argumentimin sikundër pasqyruar në paragrafin më lart. Në parashtrime, subjekti deklaroi se është sqaruar *hollësisht nga vëllezërit*, se burimi i shumës së huas është krijuar në sajë të aktivitetit tregtar të shoqërisë, e cila likuiditetet i krijon nga situata të ndryshme financiare, si qarkullim shitje-blerje, overdraftin, *Kontratën me Kredi nr. {***}/{***}, datë 04.03.2011*, nga e cila, në lidhje me nevojat e biznesit, kanë marrë një shumë të konsiderueshme dhe kanë kryer transaksione financiare sa herë ka lindur nevoja.

14.10. *Së dyti*, referuar kontratës së kredisë me kufi, datë 04.03.2011 (overdrafti), lidhur mes Raiffeisen Bank dhe kredimarrësit “{***}” ShPK, objekt i kontratës është dhënia e kredisë në kufi “në llogarinë rrjedhëse, me kërkesë të kredimarrësit”, me qëllim dhënien e “likuiditeteve kredimarrësit për kapital punues”. Palët kanë përcaktuar se kredia nuk mund të përdorej nga kredimarrësi për qëllime të ndryshme. Për rrjedhojë, edhe në kuptim të objektit të kësaj kontrate, shuma e overdraftit nuk mund të përdorej drejtpërdrejt për dhënien e huas prej 5.500.000 lekësh, për blerje të apartamentit nga vëllai i ortakut të vetëm të shoqërisë (subjekti i rivlerësimit).

14.11. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se shoqëria “{***}” ShPK, në periudhën e dhënies së huas, ka pasur në Raiffeisen Bank tri llogari rrjedhëse: llogaria në lekë (llogaria e lidhur me overdraftin), dhe dy llogari në valutë, një llogari në euro dhe një llogari në dollarë amerikanë. Në mënyrë konsistente, në ankim, sikundër edhe në parashtrime për rezultatet e hetimit administrativ

²⁴ Subjekti parashtron se, pasi është njohur me gjetjen për të cilën i ka kaluar barra e provës, ka informuar vëllezërit e tij, të cilët kanë angazhuar një auditues ligjor, të cilët i kanë adresuar 7 pyetje: 1. Sa është xhiro e afarizmit për periudhën janar – maj 2012, sipas librave të shitjes, nga totali sa janë shijet me bankë dhe sa me arkë?; 2. Sa është shuma e arkëtuara nga shitjet gjatë kësaj periudhe me kasë?; 3. Sa janë tërheqjet nga Banka për këtë periudhë?; 4. Sa janë derdhjet në Bankë për këtë periudhë?; 5. Sa janë arkëtimet në Bankë nga subjektet klientë të shoqërisë?; 6. Sa është totali i likuidimeve në bankë për këtë periudhë? dhe 7. Sa është gjendja në arkë sipas deklaratave të bërë nga subjekti “{***}” ShPK? Audituesi ligjor D. A. ka hartuar “Raportin mbi pyetjet e z. Sh. N. për shoqërinë “{***}” ShPK, datë 18.02.2020.

²⁵ Në raport, të ardhurat e përfutuara nga P. N. pasqyrohen: (i) në formë dividendi prej 1.902.000 lekësh, nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, për periudhën 2007 – 2011, për llogaritje sipas informacionit të DRT-së Lezhë; (ii) të ardhura nga pagat, 1.223.420 lekë, për periudhën 2007 – 2011, dhe 130.000 lekë për periudhën janar – maj 2012, sipas informacionit të ISSH-së dhe DRSSH-së Lezhë, për të ardhurat nga pagat, për të cilat janë paguar sigurimet shoqërore. Në raport theksohet se në këtë analizë të thjeshtë nuk janë pasqyruar investimet në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe as shpenzimet jetike të kryera nga vëllai, P. N.

kryesisht, subjekti ka pretenduar se burimi i krijimit të huas së dhënë nga i vëllai janë të ardhurat e gjeneruara nga shitjet, të disponuara në arkën e shoqërisë, në periudhën janar – maj 2012. Subjekti i është referuar raportit të parë të audituesit ligjor, që merr në analizë gjendjen e arkës dhe lëvizjet e llogarisë në lekë të shoqërisë, linjë overdraft për periudhën e sipërpërmendur, pa përfshirë në analizë kreditimet dhe debitimet *cash* në llogaritë e tjera të shoqërisë në valutë, në Raiffeisen Bank. Nga verifikimi i kryer në Kolegj nga Njësia e Shërbimit Ligjor, me fokus deklaratat e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së), si edhe librave të shitjeve dhe blerjeve të printuara nga sistemi tatimor C@ts, për këtë periudhë, rezultoi se blerjet e shoqërisë kanë qenë në vlera më të larta sesa shitjet e realizuara²⁶.

14.12. Nga ana tjetër, trupi gjykues konstaton se në dokumentacionin e shoqërisë “{***}” ShPK nuk pasqyrohet detyrimi i subjektit për pjesën e pashlyer të huas, prej 1.800.000 lekësh. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kopje të regjistrimit të vendimeve të shoqërisë, në të cilat të pasqyrohej regjistrimi i vendimit të ortakut të vetëm, P. N., për marrjen e huas edhe me dokumentacionin e paraqitur në Kolegj, me të cilin pretendon të provojë se kreditimet në llogaritë në valutë të shoqërisë kanë burim huan e marrë nga të tretët, shuma të cilat, në qoftë se do të kishin burim gjendjen në arkën e shoqërisë, do të passillnin pamundësi për P. N., për dhënien e huas²⁷.

14.13. Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, duke konstatuar parregullsitë në dukje në evidentimin e pasqyrimin e likuiditeteve dhe lëvizjes mes ortakut si individ e shoqërisë, vlerësoi se ato i atribuohen huadhënësit. Sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, personi tjetër i lidhur/huadhënësi, ka pasur të ardhura individuale të ligjshme nga aktiviteti tregtar, ndonëse jo në masën e huas së dhënë. Pavarësisht këtyre parregullsive, mundësitë financiare të huadhënësit, me përdorimin e gjendjes së arkës në datën 29.05.2012, konfirmohen.

14.14. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se vetë subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e tij si subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003, e më pas, për efekt të procesit të rivlerësimit. Transaksionet kanë lënë gjurmë e janë të dokumentuara me akte të kohës dhe janë deklaruar rregullisht prej tij. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se, nëse ka pasur mungesa evidentimi apo parregullsi në pasqyrimin e likuiditeteve nga personi tjetër i lidhur, ngarkimi i përgjegjësisë për to subjektit të rivlerësimit, në këtë proces, do të ishte disproporcional dhe do të shkonte përtej qëllimit të ligjbërësit në krijimin e kuadrit kushtetues e ligjor të rivlerësimit.

15. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se konstatimi i Komisionit, për veprime aktive të subjektit në nënshkrimin e një kontrate, nëpërmjet të cilës ka fituar pasurinë e mësipërme, në mungesë të palës shitëse, nuk rezulton të jetë shoqëruar me një pasojë konkrete në procesin e rivlerësimit. Në këto kushte, argumentet dhe arsyetimi i Komisionit në vendim, në drejtim të këtij qëndrimi, është pa vlerë përcaktuese. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e çmoi të panevojshme të ndalet në analizën e këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, ndonëse i mori në konsideratë dhe i administroi edhe provat e përcjella nga subjekti në ankim dhe në seancën gjyqësore në Kolegj, në kundërshtim të këtij aspekti.

²⁶ Konkretisht, nga shitjet për periudhën janar – maj 2012, në vlerë totale prej 8.094.591 lekësh, shoqëria “{***}” ShPK ka arkëtuar në arkë shumën 6.971.391 lekë, ndërsa pjesa tjetër, prej 1.123.200 lekësh, ka kaluar direkt në llogarinë bankare të shoqërisë. Gjithashtu verifikohet hyrje në arkë e shumës prej 1.200.000 lekë, me burim tërheqjet në bankë nga llogaria e overdraftit.

²⁷ Ligji nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në Kreun I, “Asambleja e Përgjithshme”, nenin 81, “Të drejtat dhe detyrimet”, në pikën 3, parashikon: “Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakut i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen... Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme...”.

16. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se vendimi nr. 337, datë 18.01.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, *nuk* është i bazuar dhe duhet të ndryshohet. Po ashtu, në kushtet që nga kontrolli i dy kritereve të tjera të rivlerësimit, subjekti ka rezultuar i përshtatshëm dhe se arrin nivel minimal kualifikues, ndryshimi i vendimit të Komisionit për kriterin e kontrollit të pasurisë, passjell konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 337, datë 18.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Bib Ndreca.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 22.05.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi